



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 5, datë 25.03.2025

PËR
MIRATIMIN E “PASQYRAVE FINANCIARE TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2024”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, pika 2 dhe 3, të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, dhe nenit 62, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 8, pika 2, shkronja “l” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Pasqyrave financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2024”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e pasqyrave financiare të audituara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Autoritetin Mbikëqyrës, sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.





3. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

